




DPK/DMP

03-213/2013



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

02

31-01-2013

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA  
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Regj.I.nr.7558/2012

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni i Kundërvajtjes , në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Bedri Musa nga fsh.Bajgorë ,komuna e Mitrovicës , për shkak të kundërvajtjes nga neni 9 , lidhur me nenet 5 dhe 6 par. 1 pika 1,2 , e sanksionuar sipas nenit 17.par.1. pika 1,1 të Ligjit Për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin,Prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë /Ligji nr.04/L-50/,e në bazë të nenit 9,73,74,195 dhe 199 të Ligjit për Kundërvajtjet,me datën 25.01.2013, bjen këtë:

### A K T V E N D I M

I pandehuri:Bedri Shefqet Musa i lindur me datën 01.11.1969 në fsh.Bajgorë komuna e Mitrovicës ,Këshilltar në Asamblenë Komunale në Mitrovicë,i martuar,prind i 3 /tre/ fëmijëve ,ka të kryer Shkollën e lartë pedagogjike ,i gjendjes së mesme ekonomike ,i padënuar për kundërvajtje,me vendbanim të përhershëm në fsh.Bajgorë komuna e Mitrovicës

### Ë s h t ë p e r g j e g j e s

Sepse si zyrtarë i lartë publik Këshilltar në Asamblenë Komunale në Mitrovicë nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetorë të pasurisë në Agjencinë Kundër Korupcionit të Kosovës për vitin 2012.

- me ç'rast ka bërë kundërvajtje nga neni 8 par.1 lidhur me nenet 5 dhe 6.par.1 pika 1,2 e sanksionuar me nenin 17,parag.1 pika 1,1 të Ligjit Për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin,Prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë /Ligji nr.04/L-50/,andaj në bazë të dispozitave të të njejtit ligj,e në pajtim me dispozitën e nenit 9 të Ligjit për Kundërvajtjet,

### D Ë N O H E T

Me gjobë në shumë prej 450.-€ /katërqindpesdhjetëeuro/,të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh,nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi ,në të kundërtën dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 22 ditësh./ **duke llogaritur një ditë burgu 20 €.**

I pandehuri është i obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës t'a paguaj shumën paushale prej 5.- ( pese) €. tek kjo gjykatë.

Aktvendimi iu dërgohet : të pandehurit dhe kerkesë-dhënësit.

### A r s y e t i m

Agjencioni kundër Korrupcionit në Prishtinë,me kërkesën nr.01-2529/12 të datës 13.07.2012,ka propozuar që kundër të pandehurit Bedri Musa të fillohet procedura kundërvajtëse për shkak të kundërvajtjes nga neni 8 par.1 lidhur me nenet 5 dhe 6 par. 1 pika 1,2 , e sanksionuar sipas nenit 17.par.1. pika 1,1 të Ligjit Për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së zyrtarëve të lartë

03-213/2013/02  
Skuz

publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë /Ligji nr.04/L-50/, të shpallet përgjegjës dhe dënohet sipas ligjit.

I pandehuri në procesverbal pranë kësaj gjykate me date 19.12.2012 deklaroi: "Është i vërtetë fakti se jam këshilltar në Asamblenë komunale në Mitrovicë prej vitit 2010, dhe me rastin e fillimit të mandatit kam qenë i informuar dhe më janë dorëzuar formularët për deklarimin e pasurisë të cilën gjë edhe e ksm bërë në vitin 2010. Prej atëherë nuk jam informuar asnjëherë dhe nuk është kërkuar nga unë që ti plotësoi dhe dorëzoi formularët mbi deklarimin e pasurisë. Pra nuk kam qenë i informuar dhe nuk kam qenë në dijeni se për qdo vit duhet ta plotësoi dhe dorëzoi formularin në agjencion."

Me qëllim të vërtetimit dhe konstatimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjatë procedurës është dëgjuar edhe dëshmitari Fitim Rama, Koordinator i njisisë për të drejtat e njeriut në Komunën e Mitrovicës, njëherit person kontaktues me Agjencinë Kundër Korrupsionit i cili deklaroi: "Pasi që e kam marrë emailin nga Agjencioni lidhur me informimin e gjithë zyrtarëve të lartë publik të punësuar në institucionin e komunës së Mitrovicës, menjëherë i kam informuar të gjithë me obligimin që e kanë ndaj agjencionit dhe ua kam shpërndarë formularët në mënyrë individuale, dhe shumica prej tyre në afatin e caktuar kohorë i kanë plotësuar dhe i kam dorëzuar në agjencion. Ndërsa sa i përket rastit konkret me përgjegjësi të plotë deklaroi se edhe këtij këshilltari iu ka dorëzua personalisht informacioni dhe formulari për obligimin e tij që deri me dt.31.03.2012, ta plotësoi dhe dorëzoi formularin ose personalisht përmes personit kontaktues gjë të cilën sipas të gjitha gjasave i përmenduri nuk e ka bërë. Për gjithë këtë ka qenë i informuar edhe shefi parlamentar i partisë të cilës i përket i përmenduri."

Gjykata duke vlerësuar mbrojtjen e të pandehurit, dëshminë e dëshmitarit si dhe të dhënat në kërkesë, konstatoi se i pandehuri Bedri Musa, si zyrtarë i lartë publik, këshilltar në Asamblenë Komunale në Mitrovicë, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë për vitin 2012, andaj gjykata bëri rikualifikimin e kundërvajtjes dhe gjeti se në rastin konkret në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e kundërvajtjes nga neni 8 par.1, lidhur me nenet 5 dhe 6 par.1, pika 1,2, e sanksionuar sipas nenit 17 par.1, pika 1,1 të Ligjit Për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë /Ligji nr.04/L-50/, për të cilën kundërvajtje gjykata të pandehurin e shpallë përgjegjës dhe dënon me gjobë në shumë prej 420.-€.


Gjyqtari pas vlerësimit të provave, deklaratës së të pandehurit i cili e mohon faktin se ka qenë i informuar nga ana e zyrtarit komunal lidhur me obligimin për plotësimin e formularëve dhe parashtrimin e tyre në Agjencion, nuk e ka bërë një gjë të tillë, nuk ia kushtoi besimin nga fakti se i pandehuri nje deklaratë të tillë e bëri me qëllim të shmangejes nga përgjegjësia, dhe më tepër besim i kushtoi deklaratës së personit kontaktues me agjencionin antikorupcion i cili në mënyrë bindëse deklaroi se ua ka shpërndarë informacionin dhe formularin të gjithë personave sipas kërkesës së agjencionit dhe se deklaratën e tillë e konfirmuan edhe zyrtarët tjerë të cilët janë proceduar në këtë gjykatë sipas lëndës I.nr.7559/12, për çka edhe i pandehuri shpallet përgjegjës dhe dënohet sikur është përcaktuar në dispozitiv të aktvendimit.

Gjatë caktimit të denimit u morën para syshë rrethanat e parapara me nenin 9 të LK, dhe u kosntatua se në rastin konkret me kundërvajtje nuk janë shkaktuar pasoja të rënda, ndërsa ekzistojnë rrethana lehtësuese si gjendja ekonomike e të pandehurit (realizon të ardhura mujore nga mardhënja e punës në Shkollën fillore "Mehë Uka" në fsh. Bajgorë në shumë prej 372.82 € për muaj), është kryefamiljar, baba i 3 fëmijëve, dhe gjyqtari është i mendimit që edhe më një denim më të butë mundë të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kundërvajtëse është bërë në bazë të nenit 109 al. 2 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar **ankesa** në afat prej 8 ditësh prej ditës së marrjes së aktvendimit Gjykatës së Apelit-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni i Kundërvajtjes, përmes kësaj Gjykate.

U vendos në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni i Kundërvajtjes, me datën 25.01.2013 Regj.I.nr.7558/2012.



GJYQTARI  
Sabir Rama